

## **Trupa gjyqësore pranë Gjykatës Administrative Shkalla e Parë, Shkodër.**

Më poshtë do të pasqyrojmë biografinë e gjyqtarëve pranë Gjykatës Administrative Shkalla e Parë, Shkodër.

### **Biografia e Zv/Kryetares së Gjykatës**

**Znj. Afërdita Caco** është Zv. Kryetare e Gjykatës Administrative Shkalla e Parë, Shkodër, nga muaji Maj 2021. Ajo ushtron dhe kompetencat e Kryetares së kësaj gjykate.



Pas përfundimit të studimeve universitare për Drejtësi pranë Universitetit të Tiranës, ajo ka ndjekur studimet e avancuara Master i Nivelit të Dytë.

Ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2015-2018 me rezultate shumë të mira në lëndët administrative.

Në muajin Korrik 2019 është emëruar Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative Shkalla e Parë, Shkodër.

Përvoja e saj e mëparshme e punës përfshin detyra të ndryshme, si: Lektore, Drejtuese e Njesisë së Cilësisë dhe Akreditimit pranë Universitetit POLIS, dhe eksperte ligjore për organizata të ndryshme në Shqipëri.

Mandati i saj në detyrën e Zv. Kryetares së Gjykatës Administrative Shkalla e Parë, Shkodër është një mandat me afat tre vjeçar, i vlefshëm nga muaji Maj 2021 - Maj 2024.

Zj. Afërdita Caco është e vetmja femër gjyqtare në organikën e kësaj gjykate që edhe drejton këtë institucion që prej majit 2021.

## **Biografia e Z. Gentian Marku**

### **Gjyqtar i deleguar pranë Gjykatës Administrative Shkalla e Parë, Shkodër**

**Z. Gentian Marku**, u lind më datë 26 Mars 1980. Ka kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti ‘Luigj Gurakuqi’, Shkodër, gjatë periudhës 1998-2005, me rezultate shumë të mira.

Nga muaji Dhjetor 2005 deri në muajin Janar 2009 ka punuar jurist – inspektor në Dega e Policisë Elektrike Lezhë. Nga muaji Qershor 2009 - Tetor 2012 ka punuar si jurist në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.



Gjatë periudhës 2012-2015 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, duke u diplomuar me titullin ‘Magjistrat-Gjyqtar’ dhe është vlerësuar me rezultatin shumë mirë.

Pas përfundimit të studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës, Qershor 2016, është emëruar Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pukë.

Nga muaji Maj 2018 - Maj 2021 ka kryer detyrën e gjyqtarit të transferuar në Gjykatën Administrative Shkalla e Partë, Shkodër.

Nga muaji Maj 2021 e në vijim ushtron detyrën e Gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pukë dhe njëkohësisht Gjyqtarit të deleguar në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë, Shkodër.

Z. Marku ka marrë pjesë në shumë aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e së drejtës administrative, civile, penale, etj.

Gjithashtu, gjatë periudhës Prill – Qershor 2021 ka ushtruar detyrën e Pedagogut të jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër, në lëndën “E drejta administrative”.

## **Biografia e Z. Marko Boshku**

### **Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër**

**Z. Marko Boshku**, u lind më datë 09.10.1992 në qytetin e Durrësit. Është diplomuar në vitin 2014 në Fakultetin e Drejtësisë, në sistemin Bachelor 3-vjeçar, me rezultate të shkëlqyera duke u vlerësuar me medalje “Student i Shkëlqyer”.



Në vitin 2016 ka përfunduar studimet Master Shkencor në të Drejtë Civile, duke u vlerësuar me “Medalje Ari”.

Në vitin 2016, ka ushtruar profesionin e juristit në pozicionin si as/avokat dhe përfaqësues ligjor i shoqërive tregtare, duke e ndërprerë për shkak të fillimit të programit të formimit fillestar tre vjeçar, pranë Shkollës së Magjistraturës. Në vitet 2016 – 2019 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, duke u diplomuar me titullin “Magjistrat – Gjyqtar”.

Në Janar 2020 është emëruar si Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër.

Ka marrë pjesë në shumë aktivitete kombëtare e ndërkombëtare në fushën e së drejtës.


Është bashkëautor i artikullit shkencor “Instituti i begatimit pa shkak nën këndvështrimin e së drejtës ndërkombëtare private europiane dhe legjislacionit civil të Republikës së Shqipërisë”.

Nga viti 2021 e në vazhdim është angazhuar, gjithashtu, si lehtësues në programin e trajnimit vazhdues, pranë Shkollës së Magjistraturës.

## **Biografia e Z. Mirjan Mustafaj**

### **Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër**

**Z. Mirjan Mustafaj**, u lind më date 20 Qershor 1991. Ka kryer studimet Bachelor në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitet 2009 - 2012, me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 2014 ka



përfunduar shkëlqyeshëm studimet Master Shkencor në të Drejtën Civile pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Pas përfundimit të studimeve, ka ushtruar profesionin e juristit në pozicione të ndryshme, duke u angazhuar, gjithashtu, në organizata dhe veprimtari me fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në vitet 2016 - 2019 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, duke u diplomuar me titullin “Magjistrat - Gjyqtar”. Gjatë kësaj periudhe ka qenë, gjithashtu, Anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Pas përfundimit të studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës, në Janar 2020 është emëruar Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër.

Z. Mustafaj ka marrë pjesë në shumë aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e së drejtës administrative, civile, penale, etj. Ndërkohë është autor dhe bashkëautor i disa artikujve dhe studimeve në lëmin e së drejtës, nga të cilat veçojmë: “Reforma në sistemin gjyqësor: Risetë që sollën amendamentet e fundit kushtetuese dhe paketa përkatëse ligjore lidhur me organizimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të analizuara këto në raport me organizimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, “Mirëbesimi në të drejtën kontraktore. Problematika të praktikës gjyqësore” dhe “Bëgatimi pa shkak në të drejtën administrative”.